



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J. S. C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D. D.

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A.
("KEK")

PAGESA STIMULUESE PËR PERFORMANCËN E BORDIT TË DREJTORËVE
Versioni 2018

- a) Në pajtim me Nenin 20.1 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087) ("Ligji për NP"), Komisioni i Auditimit të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut ka përgatitur dhe miratuar vendim, me datë për politikat për pagesën stimuluese për performancën e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KEK-u (Ne tekstin e mëtejme 'Politikat' ose 'Deklarata').
 - b) Përveç honorarit bazë, i cili është përcaktuar me anë të Vendimit të Qeverisë Nr. 07/81 Te datës: 23.03.2016 (te bashkangjitur), secili anëtar i Bordit të Drejtorëve të KEK-ut do ketë të drejtën e një pagese shtesë në rast se ata plotësojnë objektivat përkatëse të performancës.
 - c) Në pajtim me nenin 20.5(iii) të Ligjit për ndërmarrjet publike (ligji nr. 03/l-087), i ndryshuar me nenin 12 të ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-087 për ndërmarrjet publike (Ligji Nr. 04/L-111), asnjëherë nuk duhet të ndodhë që totali i pagesave stimuluese vjetore të ndonjë prej anëtarëve të Bordit të tejkalojë gjysmën (50%) të shumës totale të honorarit të tyre bazë vjetor.
 - d) Për ta qartësuar këtë, atëherë kur një pagesë stimuluese i bëhet anëtarit për pjesëmarrje në takim, anëtari përkatës i Bordit duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë takimit, në mënyrë që të arsyetojë atë pagesë.
 - e) Vlerësimi i pagesës stimuluese për performancën e bordit të drejtorëve bëhet përmes arritjes së dy objektivave kryesore, ku secila ka peshën prej 50 përqind nga pagesa maksimale e lejuar në emër të pagesës për performancë të bordit të drejtorëve.
1. **Objektivi i parë:** Arritja e performancës pozitive të korporatës, duke operuar në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe në pajtueshmëri me praktikat etike të biznesit¹.

Nën-objektivat:

- 1.1. **40%** - Përmirësimi i pozitës financiare dhe performancës së KEK-ut - rritjes së fitimit (zvogëlimi të humbjeve)

¹ Shpjegim: Përbushja e këtij objektivi, është e njëjtë për të gjithë anëtarët e bordit të drejtorëve.

- 0% - Me humbje
- 50% - Fitim më pak se 5 milionë Euro
- 80% - Fitim më pak se 8 milionë Euro
- 90%- Fitim më pak se 10 milionë Euro
- 100% - Fitim më shume se 10 milionë Euro

1.2. 10% - Aprovimi i planit vjetor afarist dhe buxhetor të KEK-ut për vitin vijues, në pajtim me nenin 30 të Ligjit për NP

- 0 % - Aprovimi me më tepër se 3 muaj vonesë
- 60% - Aprovimi me 2 muaj vonesë
- 80% - Aprovimi me 1 muaj vonesë
- 100% - Aprovimi në kohën e paraparë me ligj

1.3. 10% - Aprovimi i pasqyrave financiare të audituara vjetore të KEK-ut, në pajtim me nenin 33 të Ligjit për NP

- 30% - Aprovimi me më tepër se 1 muaj vonesë
- 60% - Aprovimi me 1 muaj vonesë
- 80% - Aprovimi me vonesë (më pak se 1 muaj)
- 100% - Aprovimi në kohën e paraparë me ligj

1.4. 10% - Aprovimi i Raportit Vjetor të KEK-ut në pajtim me nenin 31.3 të Ligjit për NP

- 0% - Aprovimi me më tepër se 3 muaj vonesë
- 60% - Aprovimi me 2 muaj vonesë
- 80% - Aprovimi me 1 muaj vonesë
- 100% - Aprovimi në kohën e paraparë me ligj

1.5. 30% - Arritja e objektivave të korporatës bazuar në planin afarist vjetor të KEK-ut

- 0% - Arritja e objektivave më pak se 60%
- 20% - Arritja e objektivave nga 60% - 80%
- 80% - Arritja e objektivave nga 80% - 90%
- 100% - Arritja e objektivave mbi 90%

2. Objektivi dytë: Pjesëmarrja aktive e anëtarëve të bordit të drejtorëve në qeverisjen e mirë të korporatës, monitorimin e menaxhmentit dhe udhëheqjen strategjike të saj².

Nën-objektivat:

2.1. 60% - Pjesëmarrja në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Bordit dhe adresimi i duhur i çështjeve të paraqitura në çdo takim. Kjo do të përfshijë miratimin e vendimeve në Bord kur kërkohet

Deri në 20% - rritje kur një anëtar i Bordit merr pjesë në së pak 80% të takimeve të organizuara gjate vitit, ku nënkuptohet se kur një anëtar i Bordit merr pjesë në më tepër se 95 % të takimeve atëherë ka rritur 100% të kësaj nën-objektive.

2.2. 30% - Pjesëmarrja në takimet e Komisionit të Auditimit, dhe komitetet tjera të përkohshme, nëse ka, të Bordit të Drejtorëve

Deri në 25% - rritje kur një anëtar i Bordit merr pjesë në së paku 80 % të takimeve të organizuara gjate vitit, ku nënkuptohet se kur një anëtar i Bordit merr pjesë në më tepër se 95 % të takimeve atëherë ka rritur 100% të kësaj nën-objektive.

² **Shpjegim:** përmbushja e këtij objektivi është e veçantë për secilin anëtar të bordit të drejtorëve.

2.3. Vlerësimi i përgjegjësive dhe obligimeve shtesë që bartë funksioni i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, Kryesuesit të Komisionit të Auditimit dhe komiteteve tjera të Bordit, në përcaktimin e agjendës, adresimin e duhur të çështjeve, monitorimin dhe vlerësimin, si dhe raportimin e arritjeve të çështjeve të adresuara³

- 25% - vlerësimi i përgjegjësive shtesë që bartë funksioni i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve
- 20% - vlerësimi i përgjegjësive shtesë që bartë funksioni i Kryesuesit të Komisionit të Auditimit
- 15% - vlerësimi i përgjegjësive shtesë që bartë funksioni i Kryesuesve të komiteteve tjera të Bordit të Drejtorëve
- 15% - vlerësimi i përgjegjësive shtesë që bartë funksioni i anëtarit të Komisionit të Auditimit.

2.4. **10%** - Aprovimi i raporteve tremujore në pajtim me Nenin 31.1 të Ligjit për NP⁴

- 60% - Aprovimi me 1 muaj vonesë
- 80% - Aprovimi me vonesë (më pak se 1 muaj)
- 100% - Aprovimi në kohën e paraparë me ligj

- f. Ngjashëm, sa i përket pagesës stimuluese vjetore, Komisioni i Auditimit do t'i shqyrtojë dhe caktojë ato, pas marrjes së Raportit të Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të vitit përkatës, nëse çdo pagesë që u takon bazohet në kriteret e përshkruara më sipër. Nëse pagesat u takojnë, atëherë ato do të përfshihen në pagesën e ardhshme, të rregullt, mujore të anëtarëve të Bordit.
- g. Në rast se një anëtar i Bordit jep dorëheqje nga Bordi, ose atëherë kur përfundon mandati i një anëtarit të Bordit, sipas nenit 15.1 të Ligjit për NP, ata do të kenë të drejtën e pagesave stimuluese vjetore sipas përpjesëtimit, bazuar në atë se sa kohe kanë shërbyer si anëtar të Bordit për atë vit kalendarik.
- h. Të gjitha pagesat stimuluese do të zbriten sipas tatimit në të ardhura, sipas ligjit në fuqi.
- i. Pagesa stimuluese vjetore, të përshkruara në këtë dokument, nëse i takon, do të paguhet për vitin 2018.
- j. Ky version i Deklaratës e zëvendëson në tërësi dhe i shfuqizon versionet e Deklaratës të miratuara me herët nga Komisioni.

~ ~

Në emër të Komisionit të Auditimit,

Flanza Hoxha, Kryesuese

³ **Shpjegim:** Vlerësim i obligimeve dhe përgjegjësive shtesë që bartë funksioni i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, Kryesuesit të Komisionit të Auditimit dhe Kryesuesve të komiteteve tjera të Bordit, nuk duhet të kalojnë vlerën maksimale të pagesës stimuluese të lejuar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

⁴ **Shpjegim:** Ky vlerësim është i njëjtë për të gjithë anëtarët e bordit të drejtorëve